



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 24, Datë 30.01.2018

MBI

MIRATIMIN E LICENCËS TIP TË AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË GAZIT
NATYROR

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 22 dhe 23 të Ligjit nr. 102 /2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror“, si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për miratimin e licencës tip të aktivitetit të tregtimit të gazit natyror,

Konstatoi se:

- Me Vendimin nr. 163, datë 12.10.2017, ERE ka filluar procedurën për miratimin e Licencës Tip të tregtimit të gazit natyror.
- Me shkresën nr.100/52 Prot., datë 17.10.2017, ERE ka vijuar me publikimin në media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e licencës tip të tregtimit të gazit natyror duke ftuar palët e interesit të shprehin komentet apo sugjerimet mbi këtë draft.
- Me shkresën nr. 684 Prot., datë 20.10.2017, ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Autoriteti i Konkurrencës, shoqëria “ALBGAS” sh.a. dhe shoqëria “ALBPETROL” sh.a. Draft Licenca tip e tregtimit të Gazit Natyror, është përcjellë elektronikisht edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për komente.

- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët, rezultoi se mbi këtë draft-Licencë tip, janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, komentet e të cilave janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE në draft -licencë.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë Licencën tip të aktivitetit të tregimit të gazit natyror.(Bashkëlidhur)
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit AHMETI